



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.08.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.08.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “INLINE ENGINEERING “ SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi i linjës së ndriçimit publik në Komunën e Gjakovës “, Nr. i prokurimit- 632-25-5131-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-068-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “INLINE ENGINEERING “ SH.P.K., e dt.08.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi i linjës së ndriçimit publik në Komunën e Gjakovës “, Nr. i prokurimit- 632-25-5131-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-068-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 04.08.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:04.08.2025;
- 3.**Autoriteti Kontraktues, vendos që të anuloj aktivitetin e prokurimit .
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik "INLINE ENGINEERING" SH.P.K., me dt.08.08.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi i linjës së ndriçimit publik në Komunën e Gjakovës", Nr. i prokurimit- 632-25-5131-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-068-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.08.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet tuaja, janë të pa bazuara. Autoriteti kontraktues konsideron se ju nuk keni plotësuar kërkesat në FDT-së, sepse :

Pretendimi 1: Është I pabazuar, sepse ju nuk I keni plotësuar kërkesat të përshkrimit i çmimeve, prandaj nuk ju janë kërkuar sqarime shtesë lidhur me këtë pikë sipas nenit 72 të LPP-së.

Pretendimi 2: Komuna e Gjakovës për aktivitetin e prokurimit të Zgjerimit të Linjës së Ndriçimit Publikë ka kërkuar që një dritë LED 50w ti ketë 50 pika(led) me 1w fuqi ndriçimi pra gjithsej 50w një dritë. Gjë të cilën ju nuk e keni të dëshmuar me specifikacionin e kërkuar (pretendoni që ledat e ofruar e përmbushin kriterin e lart përmendur).

Pretendimi 3: Gjatë vlerësimit të dokumentacionit ne nuk e kemi hasur specifikacionin e dritës me fuqi 146lm të paraqitur.

Pretendimi 4: Gjatë vlerësimit të dokumentacionit ne nuk e kemi hasur në specifikacion me temperature pune -40 deri 60 gradë celsius të paraqitur.

Pretendimi 5: Sipas pikës 5 është e pranueshme edhe standarti më i lartë i xhamit.

Pretendimi 6: Mungojnë linqet dhe web-i ku janë të vërtetuara (dokumentuara) certifikatat e laboratorit. Nuk na duhen certifikata apo dokumente shtesë përveq linqeve dhe web-it të laboratorit të pavarur.

Pretendimi 7: Mungojnë katalogët për të gjitha materialet elektrike përveq dritave dhe shtyllave.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.



Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

